



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2022, mori këtë

V E N D I M
P Ë R
BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2021 NË VITIN 2022

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake, nga viti 2021 në vitin 2022, në shumë prej **44,645,470.80 €**.

II.

Qëllimi i Vendimit, si në pikën 1, është:

1. Bartja e të hyrave vetanake nga vitit 2021 në vitin 2022, në shumë prej **44,645,470.80 €**.
- 1.1 Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021 është në vlerë prej **34,753,744.35 €**;
- 1.2 Tejkalimi i planit për të hyra vetanake në vitin 2021 është në vlerë prej **9,891,726.45 €**.

III.

Mjetet e bartura nga viti 2021 do të destinohen në kategoritë për:

a) paga dhe shtesa – 111	1,000,000.00 €;
b) mallra dhe shërbime – 110.....	14,145,430.83 €;
c) komunal – 132.....	400,000.00 €;
d) subvencione dhe transfere – 200	2,813,208.40 €;
e) investimet kapitale – 300	26,286,831.57 €;

Gjithsej: **44,645,470.80 €**

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-401/03-94160/22, më 29.04.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kujtesa



Ar sy e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi ve dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Tejkalimi i planit për të hyra vetanake përfshinë vlerën e mbledhur mbi planin buxhetor për vitin 2021, në vlerë prej 7,156,653.75 €, si dhe mjetet nga gjobat e trafikut, gjobat e gjykatave dhe gjobat pyjore për vitin 2021, në vlerë prej 2,735,072.70 €, gjithsej mjetet për tejkallim të të hyrave vetanake për vitin 2021 janë 9,891.726.45 €.

Dedikimi i këtyre mjeteve sipas kategorive, do të jetë:

- Kategoria e pagave dhe shtesave, duke u bazuar në lëndët me vendim nga gjykata, për kthimin dhe kompensimin e zyrtarëve të larguar nga puna, obligime të parapara në vlerë prej 1,000,000.00 €;
- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, janë obligime ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, janë për konkurse ndërkombëtare për projekte ideore/zbatuese, për bashkëfinancime me partnerët e jashtëm për projekte, obligime në vlerë prej 14,145,430.83 €;
- Kategoria e shpenzimeve komunale, për plotësimin e nevojave për obligime ndaj kësaj kategorie dhe ndryshimeve të çmimeve në treg, janë të parapara 400,000.00 €;
- Kategoria e subvencioneve dhe transfereve, obligimet e mbetura ndaj operatorëve për subvencionimet e bujqësisë për zhvillimin rural, subvencionimin e mbetur të projekteve të Kulturës, subvencionimin për ngrohje të qytetit, të gjitha obligimet janë në vlerë prej 2,813,208.40 €;
- Kategoria e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë në OSHP, si dhe projekteve të cilat janë në procedura, obligime në vlerë prej 26,286,831.57 €.